



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:241718

Datë: 06.09.2024

Numri i dokumentit: 06130695

KA.nr.432/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arben Toska, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “C...K...” organizatë joqeveritare me numër të regjistrimit ... në Departamentin për Organizata Jo-Qeveritare të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe me seli në rrugën ... p.nr. në Ferizaj, të cilën në bazë të prokurës e përfaqëson shoqëria e avokatëve GHG me seli në rrugën Agim Ramadani, H-1, nr. 10 në Prishtinë, kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të aktit administrativ, jashtë seancës më 6 shtator 2024 mori këtë:

AKTVENDIM

- I. Gjykata Komeriale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar çështjen juridike sipas padisë së paditësit “C...K...” organizatë joqeveritare me numër të regjistrimit ..., kundër të paditurit Organi Shqyrtues i Prokurimit, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi OSHP:2024/0520 i datës 05.08.2024 i të paditurit, si dhe shfuqizimin e vendimit të autoritetit kontraktues të datës 31.05.2024 në aktivitetin e prokurimit me numër 633-024-006-211.
- II. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi kjo lëndë se bashku me shkresat e saj i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative për veprim të mëtutjeshëm.

ARSYETIM

Paditësi më 03.09.2024 ushtruar padi ndaj të Paditurit, me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të anulohet vendimi OSHP:2024/0520 i datës 05.08.2024 i të Paditurit, si dhe shfuqizimin e

vendimit të autoritetit kontraktues të datës 31.05.2024 në aktivitetin e prokurimit me numër 633-024-006-211. Padiësi gjithashtu ka paraqitur edhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit OSHP:2024/0520 i datës 05.08.2024 të së Paditurit.

Pas shqyrtimit paraprak të padisë dhe shkresave tjera të lëndës, gjykata vëren se Padiësi nuk është shoqëri tregtare, rrjedhimisht në bazë të nenit 19 dhe 392 të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së kryesisht e shqyrtoi kompetencën e vet lëndore.

Neni 2 [Fushëveprimi] i Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale (këtu e tutje LGjK) shprehimisht ka paraparë se *“Ky ligj zbatohet ndaj të gjithë personave juridikë dhe fizikë, vendorë dhe të huaj përfshirë shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare në Republikën e Kosovës të cilët kanë konteste tregtare ndërmjet tyre”*, ndërsa neni 3 [Përkufizimet] i LGjK-së në para. 1 nënpara. 1.11 kontestin tregtar e ka definuar si *“çdo kontest mes shoqërive tregtare, shoqërive tregtare dhe subjekteve publike dhe të gjitha konflikteve administrative të shoqërisë tregtare, siç përcaktohet në nenin 13 të këtij Ligji”*. Në këtë drejtim, neni 13 [Kompetencat e Gjykatës Komerciale] i LGjK-së, në para. 1 nënpara. 1.12 ka rregulluar se *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë (...) 1.12. kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative;”*. Gjithashtu, para. 5 nenit 13 të LGjK-së ka përcaktuar se *“Të gjitha çështjet e përcaktuara në nën-paragrafin 1.12 të paragrafit 1 të këtij neni do të trajtohen në shkallë të parë nga Departamenti për Çështje Administrative”*.

Sipas dispozitave të cituara më lartë, sidomos nenit 13 para. 1 nënpara. 1.12 të LGjK-së, konfliktin administrativ në Gjykatën Komerciale juridikisht mundet ta hap vetëm (ekskluzivisht) një shoqëri tregtare. Sipas nenit 3 para. 1 nënpara. 10 të LGjK-së me termin *“shoqëri tregtare”* kuptohen të gjitha shoqëritë tregtare të përcaktuara në Ligjin për Shoqëritë Tregtare. Në anën tjetër, sipas nenit 5 para. 1 të Ligjit 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare (këtu e tutje LShT) *“Një Shoqëri Tregtare mund të themelohet në Kosovë si Biznes Individual, Ortakëri e Përgjithshme, Ortakëri e Kufizuar, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar ose Shoqëri aksionare”*. Meqenëse në padi dhe nga provat në shkresat e lëndës rrjedh se Padiësi është organizatë joqeveritare e regjistruar në Departamentin për Organizata Jo-Qeveritare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, atëherë ai nuk paraqet shoqëri tregtare.

Prandaj, duke u nisur nga fakti se Padiësi nuk është subjekt juridik i regjistruar në ARBK si shoqëri tregtare në bazë të LShT-së, por është regjistruar si organizatë joqeveritare në regjistrin përkatës, atëherë kjo gjykatë në bazë të nenit 17 para. 2 të LPK-së vjen në përfundim që Gjykata

Komerciale nuk është kompetente në pikëpamje lëndore për të gjykuar në këtë konflikt administrativ.

Gjykata vendosi si në pikën II. në bazë të nenit 12 para. 4 dhe nenin 17 të Ligjit nr. 06/L - 054 për Gjykatat, sipas të cilëve Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj.

Për këto arsye, në kuptim të nenit 392 para. 1 nënpara. b) të LPK-së lidhur me nenin 63 të LKA-së dhe dispozitat e cituara më lartë të LGJK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Gjykata Komerciale e Kosovës

Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.432/24

Gjyqtari

Arben Toska

UDHËZIMI PËR MJETIN E GODTIJES: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet ankesë brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa në formë të shkruar dhe në ekzemplarë të mjaftueshme për gjykatën dhe secilën palë tjetër dorëzohet në këtë gjykatë, ndërsa i drejtohet Dhomës së Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale.